



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; 2268142

Nr. 1544 Prot.

Tiranë, më 27.07.2017

**V E N D I M**

Nr.182, datë 27/07/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 132, datë 24.12.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 132, datë 24.12.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat",

**VËREJ SE:**

Bazuar në Vendimin Nr. 64, datë 02.07.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Berat", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë Këshillit të Qarkut Berat. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 132, datë 24.12.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin, Këshilli i Qarkut Berat", në të cilin është vendosur:

1. "Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Berat, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministarve, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe Lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të

Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

3. Njësia përgjegjëse, duke pasur parasysh krijimin e pozicioneve të lira të punës për shkak të dorëheqjes, për shkak të ligjit, apo për shkaqe të tjera, të hartojë, miratojë dhe publikojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, jo më vonë se muaji shkurt, i vitit përkatës kalendarik, pasi të vlerësohet dhe dinamika e ndryshimeve të diktuar nga zbatimi i reformës administrative territoriale.
4. Njësia përgjegjëse, rekrutimin në shërbimin civil, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë t’i realizojë nëpërmjet procedurave të konkurrimit, në përputhje me nenet 22, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, duke marrë të gjitha masat që të mos përsëriten më parregullësitë e karakterit procedural të lejuara në proceset e mëparshme, sado të parëndësishme qofshin në cenimin e thelbit të procesit të konkurrimit.
5. Për të gjitha rastet që janë ankimuar në rrugë gjyqësore, njësia përgjegjëse, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të veprojë në përputhje me përcaktimet e nenit 66/1 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke njoftuar për vendimet gjyqësore dhe mënyrën e veprimit në lidhje me zbatimin e tyre edhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
6. Njësia përgjegjëse, të tregojë kujdes të veçantë për të udhëhequr procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për vitin 2015, brenda afatit ligjor, duke hartuar dhe plotësuar formularët e vlerësimit të punës sipas formatit të miratuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, dhe detyrat e përcaktuara në përshkrimin e punës.
7. Njësia përgjegjëse të organizojë dhe plotësojë dosjet e personelit në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në Aneksin nr. 3: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Berat”.
8. Njësia përgjegjëse duhet të ngrejë menjëherë Komisionin e Disiplinës, në subjektin e mbikëqyrur, duke respektuar strukturën e përcaktuar në nenin 59, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, dt.05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen, vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, duke patur parasysh veçoritë që parashikohen për institucionet e pavarura.

9. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.”*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 666 prot., datë 16.11.2016, *“Në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka kërkuar nga institucioni informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi, dhe vënien në dispozicion të të gjithë praktikës shkresore që materializon zbatimin e tij, brenda një afati 10-ditor nga marrja dijani.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Këshilli i Qarkut Berat, me shkresën nr. 346/1 prot., datë 15.12.2016, *“Kthim përgjigje”*, ka vënë në dijeni Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi. Nga këqyrja e akteve bashkalidhur kësaj shkrese rezultoi se dokumentacioni i dërguar nuk ishte i plotë.

Për këtë arsye, Komisioneri, me shkresën nr. 666/2 prot., datë 25.05.2017, *“Kërkesë për plotësim dokumentacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, i ka kërkuar institucionit që për një afat 20-ditor të dërgojë praktikën shkresore që materializon zbatimin e ligjmërisë në këtë rast.

Këshilli i Qarkut Berat, me shkresën nr. 459/1 prot., datë 21.06.2017, *“Kthim përgjigje kërkesës tuaj për plotësim dokumentacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjes e Shërbimit Civil”*, ka sjellë dokumentacionin e kërkuar.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor bashkëngjitur shkresës së mësipërme, rezultoi se:

- Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 2 të Vendimit paralajmërues të Komisionerit, dhe orientimeve në Raportin Përfundimtar të Inspektimit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 459/1 prot., datë 21.06.2017, *“Kthim përgjigje kërkesës tuaj për plotësim dokumentacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjes e Shërbimit Civil”*, ka dërguar përshkrimet e punës për të gjithë nëpunësit civilë, të cilat janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, bashkëlidhur Vendimit Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*.
- Në zbatim të pikës 3, të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit, njësia përgjegjëse me aktin nr. 264, datë 24.03.2016, *“Dërgim i planit të Pranimit në Shërbimin Civil”*, ka hartuar planin vjetor të pranimit në shërbimit civil për vitin 2016, dhe i ka dërguar për publikim në portalin *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*, në përputhje me pikën 13, të Vendimit Nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimit civil”*.
- Në raportin përfundimtar të inspektimit në Këshillin e Qarkut Berat ishin evidentuar disa parregullsi të karakterit procedural gjatë procesit të rekrutimit në shërbimin civil, që nuk cenonin thelbin e tij, të tilla si: përcaktime përgjithësuese në lidhje me llojin e arsimit, publikimi i shpalljes vetëm në faqen e internetit apo stendat e institucionit dhe jo në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, etj. Për këtë arsye, në pikën 4 të vendimit

paralajmërues, objekt i këtij verifikimi, Komisioneri kishte rekomanduar njësinë përgjegjëse që të merrte të gjitha masat e nevojshme që këto parregullsi të mos përsëriteshin më në të ardhmen. Me shkresën nr. 459/1 prot., datë 21.06.2017, *“Kthim përgjigje kërkesës tuaj për plotësim dokumentacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjes e Shërbimit Civil”*, Këshilli i Qarkut Berat ka siguruar Komisionerin se ka marrë të gjitha masat që parregullsitë e evidentuara në proceset e mëparshme të rekrutimit në shërbimin civil, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, të mos përsëriten më dhe këto procese të kryhen në përputhje me nenet 22, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjeve paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*.

- Në pikën 5 të Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që për të gjitha rastet që janë ankimuar në rrugë gjyqësore, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të veprave në përputhje me përcaktimet e nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke vënë në dijeni Komisionerin për vendimet dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Me shkresën nr. 459/1 prot., datë 21.06.2017, *“Kthim përgjigje kërkesës tuaj për plotësim dokumentacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjes e Shërbimit Civil”*, Këshilli i Qarkut Berat ka njoftuar Komisionerin se për shkak të ristrukturimit të institucionit \*\*\*\*\*, me Vendimin nr. 1413 prot., datë 31.12.2014, *“Lirim nga shërbimi civil”*, është liruar nga detyra si *“Kryeinspektor”*, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës. Ky vendim është ankimuar gjyqësisht nga punonjësi në fjalë. Në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse do të njoftojë Komisionerin për vendimin e gjykatës dhe mënyrën e veprimit për zbatimin e vendimit gjyqësor për rastin në fjalë.
- Në zbatim të pikës 6 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e, Këshillit të Qarkut Berat, ka dërguar pranë Komisionerit vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit civilë për periudhën Janar-Dhjetor 2016. Nga shqyrtimi i tyre, konstatohet se procesi i vlerësimit është kryer në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.
- Në zbatim të pikës 7 të vendimit, me shkresën nr. 459/1 prot., datë 21.06.2017, njësia përgjegjëse ka njoftuar Komisionerin se ka plotësuar të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në *Aneksin nr. 3: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Berat”*, pjesë e Raportit Përfundimtar të Inspektimit, në përputhje me Vendimin Nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”*.
- Njësia përgjegjëse pranë Këshillit të Qarkut Berat, në zbatim të pikës 8 të Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, me Urdhrin e Brendshëm Nr. 30, datë 29.02.2016, *“Për ngritjen e komisionit disiplinor”*, ka ngritur Komisionin Disiplinor konform përcaktimeve të nenit 59, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen, vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*.

Përfundimisht, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar arrihet në konkluzionin se Vendimi Nr. 132, datë 24.12.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat”*, është zbatuar plotësisht nga ana e subjektit të inspektuar.

**Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Berat, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 132, datë 24.12.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat”*.
2. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Berat dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**